ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
Nr. 1274/24
Data 19.11.24

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

Prishtinë, 12 nëntor 2024
Kodi i ZRRE-së: V_2484_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Mbështetur në Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084); Nenin 9 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së; Nenin 3, 4, 5 dhe 7 të Rregullës Nr. 03/2023 për Vet-Konsumatorët me Burime të Ripërtritshme të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së, dhe Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej **3 kW,** e pranuar me datë 11.10.2024 nga aplikuesi "Enver Jusufi", me adresë: Rr. "10 Kukësi" Komuna e Prizrenit, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur më 12 nëntor 2024 nxori këtë:

V E N D I M
PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

I. **APROVOHET** - kërkesa dhe miratohet Statusi i Prosumatorit aplikuesit "Enver Jusufi" për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej **3 kW** në Komunën e Prizrenit.

II. **OBLIGOHET** – aplikuesi "Enver Jusufi" me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DPZ - 9043468 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtroj kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.

III. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.

IV. Aplikuesi "Enver Jusufi" do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me Nenin 7 paragrafi 5 dhe 6 i Rregullës Nr. 03/2023 për Vet-Konsumatorët me Burime të Ripërtritshme.

A r s y e t i m

- ZRRE, me datë 11.10.2024 nga aplikuesi "Enver Jusufi" ka pranuar aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej **3 kW** në Komunën e Prizrenit.
- Aplikuesi, s'bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të

instaluara dhe pëlqimin elektroenergjetik Nr. 13740 të datës 26.09.2024 të lëshuar nga KEDS SH.A.

- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit "Enver Jusufi" dhe dëshmive të bashkangjitura, për marrjen e statusit të prosuamtorti dhe ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej **3 kW** në Komunën e Prizrenit, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- KEDS SH.A.,
- KESCO dhe
- Arkivit të ZRRE-së.